



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2200/ 10 prot.

Datë 14.08.2026

V E N D I M
Nr. 974/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Edvin Simo	Anëtar
Donika Daci	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e dates 14.08.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 932/2026, datë 03.08.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-91948-07-01-2026, me objekt “Loti II: Arredim i kopshtit dhe i cerdhes”, me fond limit 6,366,213.50 pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar më datë 17.07.2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Albanian Furniture Office” SHPK me NIPT M32303056L dhe adresë: *Tirane Vore Autostrada Tiranë–Durrës, Picar, Njësia Administrative Vorë*
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Pogradec me adresë: *Lagjia nr 2, Bulevardi "Reshit Çollaku", Pogradec*
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 03.08.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.932/2026, ku vendosi:

1. *Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albanian Furniture Office” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-91948-07-01-2026, me objekt “Loti II: Arredim i kopshtit dhe i cerdhes”, me fond limit 6,366,213.50 pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar më datë 17.07.2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.*
2. *Autoriteti kontraktor të publikojë shtojcën për ndryshimin e dokumentave të tenderit në përputhje me vendimin e KSHA të dërguar në KPP përmes shkresës me nr. 2617/9 prot., datë 13.07.2026 protokolluar me tonën me nr. 2200/1 prot., datë 13.07.2026.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albanian Furniture Office” SHPK.*
5. *Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.2617/14 prot., datë 10.08.2026, protokolluar me tonën nr. 2200/7 prot., datë 13.08.2026, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr.932/2026, datë 03.08.2026 për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr.2617/14 prot., datë 10.08.2026, protokolluar me tonën nr. 2200/7 prot., datë 13.08.2026, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr.932/2026, datë 03.08.2026 për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.2. Bazuar në shkresën e mësipërme të autoritetit kontraktor, KPP verifikoi Sistemin e Prokurimeve Elektronike dhe konstatoi se autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, e cila është në përputhje me vendimin nr. Nr.932/2026, datë 03.08.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.3. Sa më sipër KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin e sipërcituar të KPP për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-91948-07-01-2026, me objekt “Loti

II: Arredim i kopshtit dhe i cerdhes”, me fond limit 6,366,213.50 pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar më datë 17.07.2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-91948-07-01-2026, me objekt “Loti II: Arredim i kopshtit dhe i cerdhes”, me fond limit 6,366,213.50 pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar më datë 17.07.2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Donika Daci

Anëtar
Edvin Simo

Anëtar
Nertil Kanina

Kryetar
Ismail Shehu

